



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Nr. 142

datë 22/12 / 2021

VENDIM

**Mbi dhënien e shpërblimit për familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor , për muajin Dhjetor 2021.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.137/2020 datë 16.12.2020, “Për buxhetin e vitit 2021.

**Lista e familjeve do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive.**

Mbështetur në relacionin dhe projekt-vendimin e paraqitur nga administratorët e sektorit të ndihmës Ekonomike, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI**

1- Të përfitojnë shpërblim me rastin e festave të fundvitit, nga **fondi i buxhetit vendor** , 24 **familje**, me fond prej **72.000 lekë**.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social** dhe **Drejtoria e Financës**

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK  
**Eva NAÇI**

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK  
**Erjon NEXHIPI**

